

Si të ushqejmë lopët me rendimet të lartë

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe

Aksioneri i AUSTRIA Prämix shpk

Thuajse çdo mbarështues gjedhi ka në stallën e tij lopë me potencial gjenetik për rendimente qumështi mbi mesataren. Një rendiment i lartë qumështi është çelësi i suksesit në mbarështimin e gjedhit. Baza për të ushqyerit e lopëve me rendiment të lartë, në rradhë të parë është sigurimi i ushqimit voluminoz cilësor, sigurimi i një konsumi të lartë të ushqimit dhe përcaktimi i nivelit energjik dhe proteinik të koncentratës, përshtatur me rendimentin e pritshëm.

1. Kërkesat ushqimore të një lope me rendiment të lartë

Sigurimi i rendimentit të qumështit nga 3500 deri 4500 kg qumësht nëpërmjet ushqimit voluminoz.

Ushqimi voluminoz – Silazhi ushqime të thata

- Si pasojë e kufizimit të konsumit të lëndës së thatë është i domosdoshëm një koncentrim më i lartë i energjisë në ushqim.
- Përbërësit (ndër të tjera edhe plehërimi) dhe stadi i vegjetacionit (momenti i korrjes) përcaktojnë nivelin e energjisë (MJ NEL) në bar, tërfil, silazh tërfili, jonxhë dhe të produkteve të tyre të konservimit.
- Koha optimale e korrjes. Kosa e parë duhet të ndodhë në fillim të çeljes dhe në stadin e daljes së filizave. Ushqimi i prodhuar nga bimë të kositura në momentin e çeljes nuk është i përshtatshëm për lopët e rendimentit të lartë (shikoni tabelën më poshtë).

Përmbajtja e lëndëve ushqyese, konsumi i ushqimit dhe rendimenti i qumështit në momente të ndryshme kositje.

Silazhi nga kosa e parë

Treguesit	Stadi i vegjetacionit			
	Fillimi i çeljes dhe formimi i filizave të rinj	Çelja dhe filizat e rinj.	Fillimi deri në mesin e çeljes së lules	Fundi i çeljes së luljes
Stadi i vegjetacionit	0-2	4-6	7-12	13-14
Përmbajtja e fibrës (%kg TM)	24-25	26-27	28-30	>30
Përmbajtja e energjisë (MINEL/TM)	6,6-6,5	6,4-6,2	6,0-5,8	< 5,5
Konsumi lëndës së thatë (relativ %)	100-94	92-89	86-82	80-78
Konsumi i energjisë (relativ %)	100-94	89-84	79-75	71-68
Rendimenti i qumështit/Lopë në ditë (relativ %)	100-90	80-72	64-56	50-43

- Hiri ose mbetjet e dheut të larta, shkaktuar nga kontaminimi i masës së barit, prej një kositje të bimës në nivelin më pak se 6 cm ose nga shkeljet e parcelës nga makineritë si dhe nga plisat e tokës në parcelë, ul nivelin e energjisë, përkeqëson procesin e fermentimit dhe ngadalëson tretjen.
 - Në një silazhim të vonuar, bie niveli i mineraleve dhe veçanërisht BETA karotina, e cila ulet në nivel deri 50%.
 - Silazhi duhet të ketë një nivel të lëndës së thatë nga 30% (silazh misri) deri maksimalisht 45% (silazh bari/jonxhe). Në nivele sipër dhe poshtë këtyre vlerave ulet konsumi i ushqimit voluminoz.
- Silazhi i misrit, është një ushqim plotësues i foragjerëve të njoma dhe i silazhit të tyre, veçanërisht në fazën e pikut të laktacionit, ku duhet të tregohet kujdes për disa fakte:
 - Mos të përdoret në racion si komponent i vetëm (maksimalisht 60% e sasisë së silazhit).
 - Tek lopët në fund të fazës së laktacionit dhe tharjes, duhet të reduktohet.

- Kur stuktura e racionit total është e ulët → është e domosdoshme të shtohet ushqim foragjer i thatë (bar i thatë apo kashtë).
- Prej nivelit të ulët të lëndëve ushqyese, makro-mikroelementeve dhe Beta karotinės në ushqimet foragjere është i nevojshëm plotësimi i racionit me premikse respektivisht nëpërmjet koncentratit.
 - Panxhari foragjer në racionin ushqimor tek lopët e qumështit është anashkaluar gjithnjë e më shumë prej kosos së prodhimit dhe prej mënyrës së ndërlikuar të magazinimit. Por në rastin kur lopët me rendiment të lartë të qumështit arrijnë pikën kritike të të ushqyerit, përdorimi i panxharit në racionin ushqimor bëhet gjithnjë e më interesant (Red Bull për lopët):
- ndihmon në tretjen më të mirë të racionin ushqimor,
- stimulon të ushqyerit,
- mbulon energjinë e nevojshme sidomos në fillimin e laktacionit, dhe
- pjesërisht zëvendëson ushqimin energjik në racione me përbërje bar të freskët, i cili ka përmbajtje të ulët energjie.

Koncentrati

Nevoja e lartë e përbërësve ushqyës tek lopët me rendiment të lartë qumështit kërkon një sasi të caktuar të lëndës së thatë tek racioni ushqimor, koncentratit mundëson lëndën e thatë të nevojshme për lopën.

Kërkesat e koncentratit

- Në racione ushqimore të përgatitura në fermë duhet të përdoren disa drithëra (maksimalisht 15% tërshërë).
- Në qoftë se doni të arrini një rendiment më të lartë qumështi, përdorni disa lloje të ndryshme komponentesh dhe këtë gjithmonë në bazë të ushqimit voluminoz, drithërave dhe ushqimit proteinik që keni.
 - Varianti 1. Koncentrati për balancim e racionit ushqimor (gjithmonë në bazë të ushqimit voluminoz, drithërave dhe ushqimit proteinik) + ushqim për rritjen e rendimentit të qumështit (nivel i balancuar i elementëve përbërës të qumështit).
 - Varianti 2 . Kombinimi i burimit energjik (grurë, elb, bërsi panxhari, misër) + burim proteinik (bërsi soje, bërsi luledielli).
 - Gjithashtu në nivele të larta të rendimentit është i rekomanduar përdorimi i misrit kokërr si komponent energjik.
- Misri kokërr nuk duhet të bluhet shumë imët, madhësia e sitës nuk duhet më pak se 5 mm (mundësisht të shtypet).

- Nëqoftëse përdoret ushqim i gatshëm ose përzierje me disa lloje ose me komponentë në fermë, duhet të kemi kujdes me raportin e sigurimit të lëndës ushqyese (shpesh herë kemi mangësi të lëndës ushqyese).
- Grazhdi i ushqimit gjithmonë duhet të jetë i mbushur dhe sa më lehtë i arritshëm.
- Konsumi i ushqimit energjik, 2-3 ditë të mbahet në të njëjtën lartësi si edhe nga fundi i të ushqyerit përgatitor (përpara pjelljes), më pas duke parë konsumin e ushqimit voluminoz, sasia duhet të rritet pak nga pak brenda 2-3 javësh dhe kjo e përshtatur sipas rendimentit.
- Mos të jepet më shumë se 2 kg ushqim energjik për vakt, 4-6 pjesë në ditë kur ushqeni lopët me rendiment të lartë.
- Sistemin me stallë të hapur është e domosdoshme dhënia e ushqimit me anë të stacioneve automatikë të ushqimit.
- Koncentrati duhet të përcaktohet sipas cilësisë së ushqimit voluminoz dhe rendimentit (shikoni shembullin e mëposhtëm).

Shembull: Përcaktimi i ushqimit energjik me silazh bari

Përbërës kg	Niveli i rendimentit në kg qumësht					
	<15	20	25	30	35	40
Silazh i barit shumë i mirë	Konsumi i ushqimit i lirë gjatë gjithë ditës					
Kashtë	2	deri				5
Përzierja e drithërave	-	2,5	4,5	4,0	4,0	2,0
Misër kokër	-	-	-	2,0	4,0	5,0
Bërsi soje 44	-	-	-	1,0	1,25	2
Bërsi luledielli	-	-	?	?	?	?

- Llogaritja e racionit është e domosdoshme për përcaktimin e të ushqyerit në bazë të rendimentit, kontrolli i ushqimit voluminoz e cila ofrohet nga ALMAKO e përmirëson saktësinë e përcaktimit të koncentratit.

2. Çfarë duhet të keni kujdes?

Lëndët ushqyese. Lëndët ushqyese të cilat përshtaten me ushqimin voluminoz duhet të jepen në bazë të rendimentit. Të dhënat e mëposhtme janë të përafërta, jo fikse. Është e domosdoshme një llogaritje specifike sipas fermës duke analizuar ushqimin.

- 1,5 – 2% të përzihet në koncentrat (të shikohet me kujdes përzierja)
- Ushqim i gatshëm i përzier me lëndë ushqyese
- Jepet manualisht ose automatikisht: racione të përshtatura për misrin, racione të përshtatura për silazhin e barit

Të ushqyerit e lopëve të qumështit

Rendimente të larta – Jetëgjatësi në shfrytëzim

Në të ushqyerin e lopëve me rendiment të lartë qumështi duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë furnizimit të vazhdueshëm me energji dhe lëndë minerale. Të ushqyerit në periudhën e tharjes dhe në fazën e paslindjes, janë vendimtare për shëndetin dhe pjellorinë e lopës.

- I rëndësishëm është të ushqyerit në dy faza gjatë periudhës së tharjes, ku rreth dy javë para pjelljes duhet të aplikohet një racion i pasur në komponente dhe ushqim voluminoz.
- E rëndësishme: Ndryshimet në racionin ushqimor nuk duhen bërë menjëherë!!!
- Pas momentit të pjelljes: lopët e qumështit duhet të konsumojnë sa më shumë ushqim!!!
- Kushti kryesor për konsumin e nevojshëm të sasisë së duhur të lëndës së thatë prej 23 kg deri 25 kg tek lopët me rendiment të lartë është ushqimi cilësor voluminoz.

Vërejtje

Devijimet në metabolizëm duhet të shmangen, mbasi ndikojnë negativisht në shëndetin dhe pjellorinë si dhe rrisin dëmtimet. Një komfort i mirë duhet të jetë standart. Komforti është kushti për lopët me rendiment të lartë dhe jetëgjatë.

Ushqimi bazë tek kafshët ripërtpëse

Ushqimi voluminoz me cilësi të lartë.

Silazhi është ushqimi voluminoz më i përshtatshëm për lopët, nëse i përmbahemi rregullave të mëposhtme të teknikës së silazhimit:

- Momenti më i përshtatshëm i korrjes:
Loljimet dhe jonxha patjetër në fazën e lulëzimit.
Misri: në momentin e dyllit.
- Korrja e pastër e foragjerëve
- Përmbajtja e duhur e lëndës së thatë:
 - Momenti i duhur i kthimit në silazhimin e loljumeve dhe jonxhës (35 – 40 % substancë e thatë).
 - Momenti i korrjes në silazhin e misrit – faza e dyllit 30% e lëndës së thatë.
- Copëtimi optimal.

Loljimet dhe jonxha 10 – 15 cm gjatësi prerjeje.

Silazhi i mistrit: çdo kokërr duhet të hapet.

- Shpërndarja e njëtrajtshme e masës së korrur.
- Ngjeshja perfekte e masës së korrur.
- Izolimi perfekt i gropës së silazhit.
- Teknikë marrjeje e kujdesshme.
Të paktën 15 cm në ditë, me sipërfaqe të vogla prerjeje.
- Sasi marrjeje e bollshme/ sipërfaqe të vogla prerjeje.



VLERAT E LËNDËVE USHQIMORE TEK LOJIMET DHE TEK SILAZHI I MISTRIT PËR KAFSHËT RIPËRTYPËSE ME RENDIMENT TË LARTË.

Kriteri i kontrollit		Bar i thatë (sanë)		Silazhi i barit		Silazhi i misrit
		1.Rritja	2.Rritje të tjera	1.Rritja	2.Rritje të tjera	
Lënda e thatë g/kg	TM	Min. 870		300-400		280-360
Proteinë g/kg	RP	100-120	120-140	140-160	150-170	Min. 70
Celulozë g/kg	RFA	270-290	250-270	250-270	240-260	190-210
Hi g/kg	RA	70-85	85-95	90-100	100-110	35-40
Energjia e zbat. Mj/kg	MA	9,4-9,7	9,2-9,5	9,7-10,1	9,3-9,6	10,6-10,8
Energjia neto Mj/kg	NEL	5,4-5,7	5,3-5,6	5,8-6,1	5,5-5,8	6,3-6,5

Rezultatet e kontrollit, të cilat qëndrojnë në anën e majtë të grafikës, interpretohen “mesatarisht të mira” për ripërtypësit (për viçat në majmëri, të cilët ende pijnë qumësht).

Proteina, celuloza dhe energjia konvertohen më pak tek ripërtypësit ekstensivë, si për shembull lopët me rendimet të lartë.

Vlerat ushqimore të kontrolluara			Vlerësimi për:		
			lope me rend. të lartë qumështi		Lopët nëna
Celuloza			↓		√
Proteina			√		↑
Energjia			↓		√